



EDUKIMI MJEDISOR



Shtator 2025

Edukimi mjedisor natyror i ndihmon nxënësit të njihen me çështje të rëndësishme dhe jetike mjedisore si: ujin, ajrin, tokën, natyrën, biodiversitetin. Edukimi mjedisor është veprimtaria akademike dhe praktike, që përfshinë studimin sistematik të mjedisit dhe gjithë marrëdhënieve që e shoqërojnë; përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Përgjatë tyre nxënësit përfshihen emocionalisht dhe fizikisht; ata mësojnë për zgjidhjen e shqetësimeve dhe problematikave të ndotjes, mbetjeve, energjisë, ekonomisë qarkulluese dhe, mbrojtjen e dashurinë për natyrën.

" Ajo që bën ka ndikim, dhe ti duhet të vendosësh çfarë lloj ndikimi dëshiron të kesh."

Jane Goodall

Mentorët e tyre, të cilët janë specialistët e edukimit mjedisor në 12 AdZM-të e vendit mbështesin, përfshijnë dhe ndërmarrin nisma të përbashkëta me nxënësit, për përmirësimin e mjedisve të ndryshme. Në sajë të këtyre veprimtarive ata zhvillojnë shprehje dhe dije mjedisore, që i bëjnë të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme e të mençur. Përmes edukimit mjedisor nxënësit e niveleve të ndryshme akademike përfitojnë:

vetëdije dhe ndërgjegjësim për mjedisin dhe sfidat mjedisore

kuptojnë dhe analizojnë probleme dhe çështje shqetësuese mjedisore

motivohen dhe përfshihen për përmirësimin e cilësisë së mjedisit në nivel lokal dhe kombëtar

ndërmarrin nisma dhe veprimtari që synojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit



Përmes kësaj përmbledhjeje mujore Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura paraqet aktivitetet e zhvilluara nga 12 Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura, përgjatë muajt shtator 2025, me nxënësit e shkollave të ndryshme në mbarë vendin; atyre që ndodhen pranë ZM-ve, në zonat rurale. Aktivitete janë zhvilluar në kuadër të ditëve mjedisore, promovimit të zonave të mbrojtura, lojërave të ndryshme edukative dhe argëtuese në mjediset e shkollave apo në natyrë, duke synuar gjithëpërfshirjen e nxënësve të të dy gjinive, niveleve të ndryshme ekonomike dhe vendndodhjen gjeografike.

Nxënës të përfshirë 501

26 Shkolla të përfshira

Specialistë të angazhuar 22

26 Mësues të përfshirë

Orë mjedisore të realizuara 26

“EDUKIMI MJEDISOR”, SHKODËR



biodiversitetit ujor
edukim mjedisor

Liqeni i Shkodrës
ndërgjegjësim

10 shtator 2025, Festivali i Liqenit (Dita I)

Në kuadër të “Festivalit të Liqenit”, specialistët e AdZM Shkodër në bashkëpunim me Qendrën Kulturore të Fëmijëve “Kujtim Alia” zhvilluan një aktivitet edukativ në Zogaj, pjesë e RNM “Liqeni i Shkodrës”. Nxënësit patën mundësi të njihnin nga afër liqenin përmes udhëtimeve me varka, pikturave dhe degustimit të produkteve tradicionale të zonës.

11 shtator 2025, Festivali i Liqenit (Dita II)

Në ditën e dytë të “Festivalit të Liqenit”, në Shkollën 9-vjeçare “Reshit Hyseni” në Zogaj, nxënësit u përfshinë në aktivitete artistike dhe lojëra edukative me temë liqenin. Përmes pikturave, vizatimeve dhe diskutimeve, ata thelluan njohuritë mbi vlerat ekologjike dhe kulturore të Liqenit të Shkodrës, duke kuptuar rëndësinë e ruajtjes dhe mbrojtjes së tij si një pasuri e çmuar natyrore.

27 shtator 2025, Dita Botërore e Lumenjve

Specialistët e AdZM Shkodër, në bashkëpunim me organizata mjedisore dhe shkollat e mesme “Hamdi Bushati”, “Nikollë Zogorjani” dhe “Kolë Margjini”, u organizua një aksion pastrimi në derdhjen e Lumit Buna, pjesë e Peizazhit Ujor-Tokësor “Lumi Buna – Velipojë”. Nxënësit u angazhuan drejtpërdrejt në pastrimin e bregut dhe u njohën me rëndësinë e ruajtjes së lumenjve dhe ekosistemeve ujore, duke kuptuar se të gjithë së bashku mund të kontribuojmë për një mjedis më të pastër.

“EDUKIMI MJEDISOR”, SHKODËR



27 shtator 2025, Dita Botërore e Turizmit

Në bashkëpunim me Well Point dhe shkollat e mesme “Hamdi Bushati” dhe “Kolë Margjini”, specialistët e AdZM Shkodër zhvilluan aktivitete edukative mbi rëndësinë e turizmit të qëndrueshëm. Nxënësit u përfshinë në diskutime, reflektime dhe vëzhgime mjedisore, duke kuptuar rolin e tyre në ruajtjen e natyrës dhe kulturës, dhe se turizmi i qëndrueshëm mund të zhvillohet në harmoni me mjedisin dhe zonat e mbrojtura.



biodiversitetit ujor
edukim mjedisor

Liqeni i Shkodrës
ndërgjegjësim

“EDUKIMI MJEDISOR”, KUKËS



16 shtator 2025, Dita Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Shtresës së Ozonit

Në kuadër të kësaj dite, specialistët e AdZM Kukës zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Krumë”. Gjatë orës u shpjegua rëndësia e shtresës së ozonit për mbrojtjen e jetës në Tokë dhe pasojat që sjell shkatërrimi i saj. Nxënësit u njohën me Protokollin e Montrealit dhe me përpjekjet ndërkombëtare për rigjenerimin e ozonit.

26 shtator 2025, Dita Botërore e Shëndetit Mjedisor

Në kuadër të kësaj dite, AdZM Kukës zhvilloi një orë ndërgjegjësuere me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Ali Podrimja”. Aktiviteti u fokusua te lidhja mes mjedisit të pastër dhe shëndetit të njeriut. Nxënësit krijuan vizatime dhe mesazhe me temën “Mjedis i shëndetshëm – jetë e shëndetshme”.

27 shtator 2025, Dita Botërore e Lumenjve

Lumenjtë janë burime jetike për natyrën dhe njeriun. Në këtë kuadër, specialistët e AdZM Kukës zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Besëlidhja e Malësisë”, Bajram Curri. Nxënësit u përfshinë në diskutime dhe aktivitete krijuese për rolin e lumenjve dhe mënyrat e mbrojtjes së tyre. U realizuan vizatime dhe slogane sensibilizuese si “Lumi i pastër, jeta e shëndetshme”.

27 shtator 2025, Dita Botërore e Turizmit

Në kuadër të kësaj dite, stafi i AdZM Kukës në bashkëpunim me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Shishtavec” organizoi një aktivitet sensibilizues mbi rëndësinë e turizmit të qëndrueshëm. Nxënësit diskutuan mbi vlerat natyrore e kulturore të zonës dhe rolin e turizmit në zhvillim dhe ruajtje të mjedisit.

edukim mjedisor

biodiversitet

shtresa e Ozonit

zona të mbrojtura





19 shtator 2025, Dita e Emëtimit Zero

Në kuadër të aktivitetit “Dita e Emëtimit Zero”, specialistët e AdZM Dibër zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës së 6-të të Shkollës 9-vjeçare “Papa Gjon Pali II”, Ulëz. Nxënësit u ndanë në dy grupe dhe morën pjesë në një pyetësor edukues, ku diskutuan rëndësinë e një ambienti të pastër për shëndetin e njeriut. Gjatë aktivitetit u theksua se sa më pak tymra dhe gazra të çlirohen në ajër, aq më i pastër dhe i shëndetshëm do të jetë ambienti ku jetojmë, duke kuptuar se veprimet e tyre të përditshme ndikojnë drejtpërdrejt tek cilësia e jetës.

30 shtator 2025, Dita Botërore e Lumenjve

Specialistët e AdZM Dibër organizuan një orë mjedisore me nxënësit e klasës së parë të Shkollës 9-vjeçare “Irfan Hajrullai” në kuadër të “Ditës Botërore të Lumenjve”. Përmes lojërave interaktive, vizatimeve dhe aktiviteteve kreative, nxënësit u njohën me lumenjtë e Shqipërisë, rolin jetik të tyre në ekosistem, dhe rëndësinë e ruajtjes së tyre si pasuri për të gjithë komunitetin. Në këtë mënyrë, ata kuptuan se mbrojtja e lumenjve është përgjegjësi e përbashkët dhe se mund të kontribuojnë aktivisht për një mjedis më të shëndetshëm.

“EDUKIMI MJEDISOR”, LEZHË



18 shtator 2025, Bota nënujore

Specialistët e AdZM Lezhë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës V të Shkollës 9-vjeçare “Fran Ivanaj”. Nxënësit u njohën me disa nga gjallesat ujore që jetojnë në bregdetin shqiptar, metodat e monitorimit dhe mbrojtjes së tyre, dhe në fund morën pjesë në aktivitete artistike dhe krijuese për të shprehur njohuritë e fituara, duke kuptuar rëndësinë e ruajtjes së botës nën ujore.

19 shtator 2025, Dita e Emetimeve Zero

Në kuadër të kësaj dite, specialistët e AdZM Lezhë organizuan një orë mjedisore me nxënësit e klasës IV të Shkollës së Mesme të Bashkuar “Ndoc Gjetja”. Pas prezantimit të materialeve informuese, nxënësit punuan në mënyrë të pavarur në kuize dhe diskutuan mënyra sesi mund të kontribuojnë në mbajtjen pastër të natyrës, duke kuptuar rëndësinë e zvogëlimit të emetimeve dhe ndikimin e tyre tek mjedisi.

26 shtator 2025, Dita Botërore e Shëndetit Mjedisor

Specialistët e AdZM Lezhë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës VI të Shkollës së Mesme të Bashkuar “Karl Gega”. Nxënësit morën njohuri mbi ruajtjen dhe mbrojtjen e natyrës dhe mënyrat sesi mund të kontribuojnë për një mjedis të shëndetshëm, duke realizuar më pas punime artistike dhe aktivitete kreative, duke kuptuar rëndësinë e shëndetit mjedisor për komunitetin.

emetime zero

aktivitete artistike

gjallesa ujore

shëndeti mjedisor

“EDUKIMI MJEDISOR”, LEZHË



27 shtator 2025, Dita Botërore e Lumenjve

Në këtë ditë, stafi i AdZM Lezhë zhvilloi një orë mjedisore me nxënësit e klasës V të Shkollës 9-vjeçare “Beselidhja”. Nxënësit morën njohuri mbi lumenjtë e Shqipërisë dhe rolin e tyre jetik për natyrën, bujqësinë, turizmin dhe jetën e përditshme, shkëmbyen ide dhe mendime, dhe realizuan kuize mbi temën, duke kuptuar rëndësinë e mbrojtjes së lumenjve si pasuri të përbashkët.

27 shtator 2025, Dita Botërore e Turizmit

Në kuadër të Ditës Botërore të Turizmit, specialistët e AdZM Lezhë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës VI të Shkollës 9-vjeçare “Marash Gjoni”. Nxënësit morën informacion mbi zonat turistike dhe turizmin e qëndrueshëm, duke krijuar postera që tregojnë si të ruajmë biodiversitetin dhe atraksionet natyrore, duke kuptuar se natyra dhe turizmi mund të bashkëjetojnë në harmoni.



emetime zero

gjallesa ujore

aktivitete artistike

shëndeti mjedisor



16 shtator 2025, Dita Botërore e Shëndetit Mjedisor

Në kuadër të Ditës Botërore të Shëndetit Mjedisor, specialistët zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës së 6-të në shkollën 9-vjeçare “Myrteza Pengili”, Krujë. Nxënësit u njohën me rëndësinë e kësaj dite dhe ndikimin që ka një mjedis i pastër në shëndetin tonë. Gjatë orës, ata diskutuan mbi mënyrat se si secili prej nesh mund të kontribuojë për një mjedis më të shëndetshëm dhe të pastër. Në vijim, nxënësit realizuan postera dhe mesazhe sensibilizuese me thënie dhe figura që nxisin mbrojtjen e natyrës dhe kujdesin ndaj mjedisit.

17 shtator 2025 Habitatet dhe rëndësia e tyre

Në kuadër të programit të edukimit mjedisor, specialistët zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës së 6-të në shkollën 9-vjeçare “Zenel Tepshi”, Krujë. Nxënësit u njohën me konceptin e habitateve, rëndësinë e tyre dhe rreziqet që i kërcënojnë. Gjatë aktivitetit, ata u përfshinë në lojëra ndërvepruese për të vendosur gjallesat në habitatet përkatëse si pyll, oqean, kënetë dhe shkretëtirë. Në përfundim, nxënësit krijuan punime në grup mbi ruajtjen e habitateve si mesazh për mbrojtjen e biodiversitetit dhe ekosistemeve natyrore.

edukim mjedisor

habitatet

biodiversiteti

ekosistemet

shëndeti mjedisor

“EDUKIMI MJEDISOR”, TIRANË



20 shtator 2025, Fushata “Pastro Botën”

Specialistë të ADZM Tiranë, në kuadër të fushatës mjedisore “Pastro Botën”, zhvilluan një aktivitet me nxënësit e klasave të 8-ta dhe të 9-ta në shkollën 9-vjeçare “Zenel Bastari”, Bastar i Mesëm. Nxënësit morën pjesë në një aksion pastrimi në hapësirën përreth shkollës, duke dhënë shembullin e tyre për kujdesin ndaj mjedisit. Gjatë aktivitetit, ata përcollën mesazhe sensibilizuese për një mjedis më të pastër dhe të shëndetshëm, duke theksuar se kujdesi për natyrën nis nga veprimet e vogla të përditshëm.

27 shtator 2025, Dita Botërore e Lumenjve

Në këtë ditë, specialistët zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës së 5-të në shkollën 9-vjeçare “Tufinë”, Tiranë. Nxënësit u njohën me rolin e rëndësishëm që lumenjtë kanë për natyrën dhe jetën e komuniteteve, si dhe me pasojat që shkakton ndotja e tyre. Gjatë aktivitetit, ata shprehën idetë e tyre përmes vizatimeve, shkrimeve dhe mesazheve sensibilizuese, duke realizuar edhe një maket tematik për mbrojtjen e lumenjve.



natyrë
orë mjedisore

aksion pastrimi
ditë botërore

16 shtator 2025 Dita Botërore e Shëndetit Mjedisor

Në kuadër të "Ditës Botërore të Shëndetit Mjedisor", specialistët e AdZM Elbasan organizuan një orë edukative për nxënësit e Shkollës 9-vjeçare "Veiz Çota" në Togëz. Gjatë kësaj ore, u theksua rëndësia e ruajtjes së mjedisit dhe ndikimi i tij në shëndetin e njeriut. Nxënësit u informuan mbi praktikat e mira për mbrojtjen e natyrës dhe pastrimin e mjedisit.



shëndeti mjedisor

ditë botërore

monument natyre

ndryshimi klimatik

zona të mbrojtura

“EDUKIMI MJEDISOR”, FIER



edukim mjedisor
pasuri natyrore

vizitë studimore
park kombëtar



13 shtator 2025 vizitë studimore

Studentët e Universitetit të Shkencave të Jetës në Pragë realizuan një vizitë studimore në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta. Gjatë vizitës, ata eksploruan vlerat natyrore dhe biodiversitetin unik të parkut, përfshirë specie të rralla shpendësh si pelikani kacurrel. Ata morën njohuri mbi ekosistemet e Lagunës dhe rëndësinë e menaxhimit dhe monitorimit të parkut nga AdZM-Fier. Vizita përfshiu një tur në terren, ku studentët mësuan për praktikën e ruajtjes së mjedisit dhe turizmit të qëndrueshëm.

18 shtator 2025, Dita Botërore e Monitorimit të Ujit

Nxënësit e Shkollës 9-vjeçare Gërmenj realizuan një orë mjedisore për të shënuar Ditën Botërore të Monitorimit të Ujit. Aktiviteti përfshiu një demonstrim të aparaturave të përdorura për monitorimin e ujërave në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta.

“EDUKIMI MJEDISOR”, KORÇË



15 shtator 2025, bota nënujore

Ora mjedisore e zhvilluar nga specialistët e AdZM Korçë , për fëmijë të grupmoshës 5 dhe 6 vjeç, e udhëhequr nga specialistë të fushës, ku njohën fëmijët me botën nënujore. Fëmijët identifikuan dhe ngjyrosën lloje të ndryshme kafshësh duke theksuar rëndësinë e ruajtjes së këtyre specieve.

25 shtator 2025, Dita Botërore e Lumenjve

Lumenjtë përbëjnë një nga pasuritë më të çmuara të natyrës, duke ndikuar drejtpërdrejt në jetën e njeriut dhe në ekuilibrin e ekosistemeve. Në kuadër të “Ditës Botërore të Lumenjve”, specialistët e AdZM Korçë zhvilluan një aktivitet mjedisor me nxënësit e klasave të 8-ta dhe 9-ta në shkollën “Avdulla Progri”, Devoll. Nxënësit morën pjesë në një aksion pastrimi përgjatë rrjedhës së lumit Devoll, duke dhënë shembullin e tyre për kujdesin ndaj mjedisit.

30 shtator 2025, Emetimet Zero

Në kuadër të programit të edukimit mjedisor, specialistët e AdZM Korçë,zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasës së 9-të në shkollën “Kozma Basho”, Pogradec. Nxënësit u njohën me efektet e gazrave serrë dhe mënyrat për reduktimin e emetimeve në atmosferë. Aktiviteti synoi ndërgjegjësimin e tyre për mbrojtjen e klimës dhe ajrit të pastër.

edukim mjedisor

zona të mbrojtura

lumenj

biodiversitet

fauna



16 shtator 2025, Dita Ndërkombëtare e Shtresës së Ozonit

Në Ditën Ndërkombëtare të Mbrojtjes së Shtresës së Ozonit, specialistët e AdZM Berat dhe nxënësit e shkollës 9-vjeçare Roshnik mbollën 10 fidanë pyjorë në një aktivitet simbolik që synoi të theksojë rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe rolin jetësor të shtresës së ozonit.

27 shtator 2025, Dita Botërore e Lumenjve

Në kuadër të Ditës Botërore të Lumenjve, specialistët e AdZM Berat së bashku me nxënësit e shkollës “Myslym Bakeri” organizuan një aksion pastrimi përgjatë shtratit të lumit Osum.

Aktiviteti synoi të japë një mesazh të qartë mbi rëndësinë e lumenjve në vendin tonë dhe të nxisë ndërgjegjësimin për mbrojtjen dhe ruajtjen e tyre.